



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 27.02.2023

Nr: 08

Ora: 12:00

VENDIM

**PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS NR. 05, DATË 17.02.2023 TË
KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 27.02.2023, me pjesëmarrjen e:

Koli BELE	-	Relator
Elvin LAKO	-	Anëtar
Elvis ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan RUSMALI	-	Anëtar
Ledio BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

OBJEKT: Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ ndaj zj. Dhurata Gjoka,
Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Durrës, për
mosraportim të veprimtarive publike brenda afatit ligjor

BAZË LIGJORE:

Nenet 21/dh, 126, dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 17, neni 34, shkronja “b” dhe neni 35 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka depozituar pranë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve kërkesën për vënie sanksioni, e cila është regjistruar në regjistrin e kërkesave për masat disiplinore, me nr. 05 regj., datë 17.02.2023. Në mbledhjen e datës 27.02.2023, ora 12:00, pas relatimit të z. Koli Bele u konstatua se kërkesa i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 35 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve” dhe në mbështetje të nenit 45, pika 1, shkronja “c”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 129, pika 3, shkronja “a”, 130 dhe 131 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës nr. 05, datë 17.02.2023 të paraqitur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve;
2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 28.02.2023 ora 12:30;

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Vendimi është i formës së prerë dhe nuk mund të bëhet ankim.

Koli BELE - **Relator**

Elvin LAKO - **Anëtar**

Elvis ÇEFA - **Anëtar**

Ilirjan RUSMALI - **Anëtar**

Ledio BRAHO - **Anëtar**